



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 75

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Prishtinë, më 10 korrik 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi dhe Liburn Aliu.

Munguan: Nazane Breca dhe Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit; Xheneta Sopjani, praktikante;

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.07.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës , para miratimit në parim
4. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.07.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së e datës 1.07.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës , para miratimit në parim

Fikrim Damka- Tha se sot kemi në shqyrtim Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës , para miratimit në parim në seancë plenare. Ky ligj është i procedura nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe do te radhitet në seancë për lexim të parë. Hap diskutimin.

Salihe Mustafa – Tha se do ta përkrah miratimin e Projektligjit në parim edhe pse Projektligji ka disa mangësi , por ato do të plotësohen gjatë amendamentimit.

Liburn Aliu- Tha se Projektligji është i hartuar relativisht mirë dhe mund të kaloj në parim.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri miratoj në parim Projektligjin për Agjencionin e punësimit në Republikën e Kosovës

4. Të ndryshme.

Fikrim Damka - Tha se jemi dakorduar mbledhjen e kaluar për të përkrahur kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për të propozuar një amendament në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, e që ka të bëjë me pagesën e preformancës. Kemi një formulim para vetes , a pajtoheni ?

Komisioni njëzëri miratoj këtë :

Amendament

Në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, të bëhet transferimi i mjeteve në shumë prej 4,293,323.60 euro nga kodi buxhetor 719 AKPSH , në kodin buxhetor sipas T.1 , nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë subvencione.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka